



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.40, datë 28.09.2007

“PËR DISA NDRYSHIME NË BUXHETIN E BASHKISË TIRANË”

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 10, gërma “f” dhe neni 32, gërma “dh”, në Ligjin Nr.8094, dt.21.03.1996 “Per largimin publik të mbeturinave”, V.K.B. Nr.23, dt.30.04.2007 “Për realizimin e Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007”, në mbështetje të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Mjedisit & Administrimit të Mbetjeve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimet në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës, në shumën prej 185.772.000 lekësh, sipas Pasqyrës Nr.1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Në mbështetje të pikës 1, të shtohet limiti i shpenzimeve operative në shumën 3.522.000 lekë, duke pakësuar në po këtë shumë limitin e investimeve në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Mjedisit & Administrimit të Mbetjeve, Drejtoria e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit & Administrimit Financiar dhe Ndërmarrja e Përpunim Plehut.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R